

VENDIM
Nr. 758, datë 13.12.2024

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “SISTEMIM I RRUGËS ‘ANDREA STATHI’, BASHKIA KORÇË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Sistemim i rrugës ‘Andrea Stathi’, Bashkia Korçë”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Korçë.
 3. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 1 545 197 (një milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 1 545 197 (një milion e pesëqind e dyzet e pesë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Korçë.
 5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Korçë.
 6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Korçë.
 8. Bashkia Korçë kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Korçë.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar, në favor të Bashkisë Korçë, sipas këtij vendimi.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë, në favor të Bashkisë Korçë, për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Korçë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Korçë, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

N. rendës	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)							VLERËSIMI PËR SHPRITËRËSIM				Shënimet, kufizime mbi pronën etj.	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Trrall (m ²)	Volum	Faqe	TRUALL				
												Sipërfaqja (m ²)	Gjini lëshi / m ²	VLERA (m ²)		VLERA (TOKË)
1	Migjena	Joragji	Demirrihu	Korçë	8564	7/292	Trrall	915.00	915.00	17	226	181	8,537	1,545.197	1,545.197	
Violandla	Enver	Sutikno														
Fatiko	Enver	Hanzai														
Alfred	Enver	Hanzai														
VLERË TOTALE															1,545.197	